



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primitje / Prodalo Received / Delivered	28 - 06 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organiç / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3779/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.457/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Avdyll Bekteshi - Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.457/2022 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.457/2022 e datës 16.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.Nr.020-/2022 i datës 15.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar Social" pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës – Burgu i Sigurisë së Lartë, me datë 16.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2845 të regjistruar me numër A.nr.457/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i Komisionit Disiplinor për ndaljen e 20% të pagës për një periudhë një (1) mujore është i padrejtë dhe antiligjor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 30.05.2022 ka pranuar përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2845/2022 të datës 16.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 04.12.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 30.05.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 08.08.2016 së bashku me formularin e përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit të datës 28.02.2012; Ftesën e datës 31.03.202 për ankuesin për Komisionin Disiplinor; Procesverbalin e intervistës për ankuesin të datës 06.04.2022; Fletë kthesën e datës 19.04.2022; E-mailat zyrtar të datës 30.05.2022, 25.05.2022, 24.05.2022; Raporti Përfundimtar i Hetimeve me Nr. 0115 i datës 07.02.2022 i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 10.03.2022; Raportin final të hetimit të datës 07.02.2022; Vendimin me Nr. 0089 i datës 31.01.2022 për formimin e komisionit të brendshëm hetimor; Kërkesën për ekzekutimin e dënimit me Nr.326 e datës 19.05.2021; Aktgjykim PS 54/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Aktgjykim APS.nr.1/21 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special; Shkresë për llogaritjen e dënimit të datës 21.03.2022; Vendimin me Nr. 747 i datës 08.10.2019 për formimin e Komisionit profesional; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref. 4.4 i datës 16.03.2021; ; Iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 16.03.2022; Fletë kthese e datës 19.04.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 06.04.2022; Kërkesën me Nr.Protokol: 901 e datës 12.03.2021; Forma e panelit për beneficione Ref.4.4.1 e datës 16.03.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref.4.4 e datës 19.03.2022; Raporti për pushim jashtë burgut i datës 22.03.2021 dhe 19.03.2021; Kërkesë me Nr.Protokol:941 e datës 17.03.2021; Certifikatë e martesës e datës 16.03.2021; Forma e panelit për beneficione Ref.4.4.1 e datës 22.03.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref. 4.1.5 e datës 30.04.2021; Kërkesën me Nr.Protokol: 1470 e datës 29.04.2021; Forma e Panelit për beneficione Forma 4.1.4/1 e datës 11.05.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.06.2021; Kërkesë me Nr.Protokol:2142 e datës 21.06.2021; Formular i Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 29.06.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.09.2021; Kërkesë e datës 28.09.2021; Formular i Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 28.09.2021; Vendimi i datës 27.10.2020; Njoftim i datës 23.03.2021, 25.05.2021, 21.07.2021, 28.09.2021; Shkresë e datës 24.03.2021, 25.05.2021 dhe 21.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e *pa bazuar*, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se procedura disiplinore ndaj ankuesit është iniciuar me datë 10.03.2022, pas pranimit të Raportit Nr.0115 të datës 07.02.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në bazë të të cilit janë konstatuar shkelje lidhur me realizimin e vizitës së lirë nga i burgosur F.M në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 15.04.2022 me Vendimin KD.Nr.020-/2022 ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore, nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 në lidhje me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse sipas Komisionit Disiplinor ankuesi si anëtar i panelit ka aprovuar beneficione - vizitë të lirë (qëndrim në lokale të veçanta) për të dënuarin F.M, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe si rrjedhojë Komisioni Disiplinor, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “ndalim 20% i pagës për periudhë një muaj”.

Kundër Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor, ankuesi me datë 16.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2845/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kontestuar është i padrejtë dhe antiligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e administruara të lëndës, konkretisht në Raportin Nr.0115 të datës 07.02.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka gjetur se Komisioni Profesional i themeluar me Vendimin me Nr.747 të datës 08.10.2019, i cili merret me shqyrtimin e kërkesave për beneficione në kuadër të institucionit korrektues, dhe në të cilin komision anëtar është edhe ankuesi, ka aprovuar raste të beneficionit, respektivisht vizitës së lirë në lokale të veçanta për të burgosurin F.M. Ndërlidhur me këtë është konstatuar se Komisioni Profesional, në këtë rast edhe ankuesi si anëtar i këtij komisioni, ka aprovuar katër kërkesa për lejimin e vizitës së lirë në lokale të veçanta për të burgosurin F.M, dhe atë: *Kërkesën me Nr:Protkol:941 të datës 16.03.2021, për lejimin e vizitës së lirë më datë 24.03.2021; Kërkesën me Nr:Protkol:1470 të datës 29.04.2021 për lejimin e vizitës së lirë më datë 19.05.2021; Kërkesën me Nr:Protkol:2142 të datës 18.06.2021 për të për lejimin e vizitës së lirë më datë 07.07.2021; Kërkesën e datës 28.09.2021 për lejimin e vizitës së lirë më datë 29.09.2021.*

Me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, konkretisht neni 48, përcaktohet se: 1. *Për realizimin e së drejtës në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta duhet të plotësohen këto kushte: 1.1. sjellja e mirë e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit; 1.2. të mos jetë shfrytëzues i pushimit jashtë institucionit korrektues.* 2. *E drejta në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta mund t'i lejohet personit të dënuar me të paktën dy (2) vjet dënim me burgim që mund të shfrytëzohet vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muajt e parë të dënimit”,* ndërsa bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Aktgjykimin me numër PS-54/20 të datës 18.12.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special është konstatuar se i burgosuri F.M është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, dhe i njëjti

aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin me numër APS.nr.1/21 të datës 10.02.2021 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti Special.

Bazuar si me sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e kërkesave për vizatë të lirë në lokale të veçanta sepse i burgosuri F.M ka qenë i dënuar me burgim me pak se dy (2) vjet, gjegjësisht një (1) vit e gjashtë (6) muaj, andaj ankuesi me veprimet e tij duke aprovuar kërkesën e të burgosurit F.M për vizitë të lirë në lokale të veçanta ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", sepse zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, siç parashihet me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjës për shkeljen e kryer të përcaktuara si në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Komisioni Disiplinor lidhur me këtë çështje juridike ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor". Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zytarëve Publikë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit se vendimi i Komisionit Disiplinor është i padrejtë dhe antiligjor, janë të pabazuara.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë vërën se i njëjti ju referohet pesë (5) zyrtarëve, ku të gjithë janë shpallur përgjegjës duke ju shqiptuar masa disiplinore veç e veç, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.457/2022 e datës 16.05.2022 dhe lënia në fuqi e Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor, ka të bëjë vetëm me pikën III të dispozitivit të këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.457/2022

Avdyl Bekteshi

Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.